



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:216415
Datë: 29.04.2024
Numri i dokumentit: 05637050

KPPP.nr.1653/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Contanti Generators” Sh.P.K., me adresë në Fushë Kosovë, Sllatinë e vogël, me NUI: 810482159, kundër debitorit “Xtremefitness03” Sh.P.K., me adresë në Pejë, rruga “Gjeneral Wesley Clark” pn, me NUI: 811299107, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.1669/23 të datës 20.09.2023, të nxjerrë nga Zyra Përmbartimore Vais Law me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datë 18.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

1. REFUZOHET NË TËRËSI i pabazuar prapësimi i debitorit “Xtremefitness03” Sh.P.K., i paraqitur kundër Urdhrit P.nr.1669/23 të datës 20.09.2023, të nxjerrë nga Zyra Përmbartimore Vais Law, dhe i njëjti Urdhër MBETET NË FUQI në tërësi.

A r s y e t i m

Zyra Përmbartimore Vais Law, me Urdhrin Përmbartimor P.nr.1669/23 të datës 20.09.2023, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, e ka caktuar përmbartimin ndaj debitorit në bazë të

dokumentit të besueshëm–faturës nr.205/21 të datës 08.10.2021, me të cilin ka urdhëruar debitorin që në emër të përmbushjes së obligimeve, brenda afatit prej 7 ditësh nga data e dorëzimit të urdhrit, t’ia paguajë kreditorit shumën e mbetur prej 4,220.00 Euro, me kamatën referente si pjesë e kamatës ligjore (lartësinë e së cilës BQK e publikon në bazë të rregullt gjashtëmujore sipas Ligjit nr.05/L-110 për Kamatëvonesa në Transaksione Tregtare) duke e llogaritur nga data kur kërkesa është bërë e arritshme e deri në pagesën definitive, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përbarimore që do të krijohen prej momentit të dorëzimit të këtij propozimi, nën kërcënim të përbarimit të dhunshëm.

Kundër urdhrit të Përbaruesit Privat, debitori ka ushtruar prapësim për shkak se dokumenti në bazë të të cilit është marr urdhri nuk ka titull ekzekutiv ose nuk ka tipare të përbarueshmërisë, dokumenti përbarimor nuk është dokument i besueshëm, si dhe për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike me arsyetimin se kërkesa nuk përputhet me ofertën. Më tej ka theksuar se e kundërshton propozimin për përbarim për faktin se është marrë vesh me kreditorin që në shenjë të kompensimit-konkretisht në shenjë të barazimit ia ka dhënë të njëjtit një gjenerator për ta mbuluar në tërësi shumën e cila ka qenë borxh. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet në tërësi si i bazuar prapësimi dhe të anulohet urdhri përbarimor.

Kreditori nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve në prapësim të debitorit dhe analizimit të shkresave të lëndës, ka gjetur se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe duhet të refuzohet në tërësi nga shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërkaq me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*. Tutje me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, dhe sipas nenit 29 paragrafit

1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori i kishte lëshuar debitorit faturën nr.205/21 të datës 08.10.2021 në shumën prej 15,000.00 Euro dhe debitori nga kjo faturë ka arritur që të bëjë pagesën e pjesshme të borxhit, ku si rrjedhojë borxhi i mbetur është në shumën prej 4,220.00 Euro, fakt ky i cili vërtetohet në propozimin për përbarim nga vet kreditori.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura e lartcekur i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 29 dhe 37 të LPP-së, për zbatimin e përbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që në këtë faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, është përcaktuar koha e përmbushjes së detyrimit, e njëjta është dorëzuar në origjinal dhe është pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, fakt ky i cili vërtetohet me nënshkrimin dhe vulën e debitorit.

Gjykata e vlerësoi pretendimin e debitorit se është marrë vesh me kreditorin që në shenjë të kompensimit-konkretisht në shenjë të barazimit ia ka dhënë të njëjtit një gjenerator për ta mbuluar në tërësi shumën e cila ka qenë borxh, mirëpo gjeti se pretendimi i tillë nuk është objekt shqyrtimi i procedurës përbarimore prandaj dhe nuk mund të vlerësohet në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përbarimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit si objekt përbarimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat e neneve 21, 22, 27 dhe 36 të LPP-së.

Andaj, bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1653/23, me datë 18.04.2024

Gj y q t a r i

Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Dhomën e Shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale të Kosovës me seli në Prishtinë.